



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Dëshiroj të shoh

25 Tetor 2015



Në atë kohë, kur Jezusi po dilte prej Jeri-honit bashkë me nxënës e me një turmë të madhe populli, biri i Timeut, Bartimeu i verbër, rrinte në anë të rrugës e lypte. Posa mori vesh se ishte Jezusi Nazarenas, filloi të bërtasë: “Jezus, Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!” Shumëkush e qortonte të heshte, porse ai bërtiste edhe më fort: “Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!”. Jezusi zuri vend e tha: “Thirreni!” Ata i bënë zë të verbërit dhe i thanë: “Mos u tremb! Çohu se po të thërret!” I verbëri hodhi mantelin e vet, menjëherë u ngrit dhe shkoi te Jezusi. Jezusi e pyeti: “Çka dëshiron të bëj për ty?” “Rabbuni! Që të shoh!” – përgjigji i verbëri. Jezusi i tha: “Shko lirisht! Feja jote të shpëtoi!” Dhe aty për aty pa e u vu të udhëtojë mbas Jezusit. *Mk 10, 46-53*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12 pm te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

26 tetor	Shen Valeriani
28 tetor	Simoni dhe Juda apostuj
31 tetor	Shen Alfonsi
01 nentor	Te gjithë shenjterit

Viti 2015, kalendar aktivitetesh...

Te shtunen **28 Nëntor** Party festa e Pavaresise; te shtunen **19 Dhjetor** Christmas Party.

2 Nëntor, Mesha per Purgatorë...

Te henen **2 Nentor ne oren 7:45pm** kremtohet Mesha per shpirtrat e besimtareve te vdekur.

Haku Kishes 2015...

E kane dhene: **Fred Kalaj, Ilir Shyti, Sokol Sokoli, Prek Spaqi, Mhill Bregu.**

Deri tani kane dhene:

Aleks	Coku
Alfred	Shllaku
Altin	Miri
Anton	Malaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Pepa
Arben	Toma
Astrit	Simeqi
Augustin	Bakaj
Beniamin	Hasko
Dritan	Lumaj
Edi	Linadi
Eduard	Shkreli
Elbert	Gashi

Fatmir	Qosaj
Franc	Shestani
Fred	Kalaj
Gac	Gjoka
Gezim	Vushaj
Gezim	Lanazi
Gjelosh	Vushaj
Gjergj	Gjinaj
Gjovalin	Ftoni
Ilir	Shyti
Ilir	Daka
Kreshnik	Kapaj
Ladi	Lumaj
Lec	Gashaj
Lek	Tarazhi
Leke	Kapllaj
Luk	Gjolaj
Lule	Tinaj
Marash	Martinaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Martin	Pjetri
Mhill	Ftoni
Mhill	Bregu
Nik	Biqi
Nikolin	Vukelaj
Nikolle	Lumaj
Nua	Selmani
Nush	Kaçaj
Pal	Rransburgaj
Paulin	Gjerkaj
Paulin	Lukani
Pjeter&Bep	Dreshaj
Prek	Spaqi
Prek	Lekaj
Preke	Gjonaj
Prel	Pepushaj
Shpend	Pllumaj
Sokol	Sokoli
Sokol	Ujka
Taulant/Elvis	Gjerkaj
Ton	Vocaj
Viktor	Pleti
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Zef	Lulaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**



DEAR JESUS,

help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

Papa: të krishterët t'i lexojnë shenjat e kohëve e të ndryshojnë, besnikë ndaj Ungjillit



"Kohët ndryshojnë e edhe ne, të krishterët, duhet të ndryshojmë

vazhdimisht", me lirinë e në vërtetësinë e fesë. Është pohimi i Papës gjatë homelisë të Meshës së mëngjesit, kremtuar në Shtëpinë e Shën Martës. Françesku reflektoi për vlerësimin e shenjave të kohëve nga ana e Kishës, pa rënë në komoditetin e konformizmit, por duke u frymëzuar nga lutja.

Kohët bëjnë punën e vet: ndryshojnë. Të krishterët duhet të bëjnë atë, që dëshiron Krishti: t'i vlerësojnë kohët e të ndryshojnë, njëherësh me to, duke mbetur gjithnjë "të patundur në të vërtetat e Ungjillit". Çka nuk duhet pranuar, është konformizmi i qetë që, në të vërtetë, të bën të rrish duarkryq, të bën të palëvizshëm.

Urtia e krishterë

Papa kishte parasysh një fragment të ri të Letrës së Shën Palit drejtuar Romakëve, që e nxiti të kujtojë Apostullin e Popujve dhe predikimin e tij, me gjithë forcën e me gjithë lirinë, që na shpëtoi nga mëkati. Por kishte edhe faqen ungjillore, në të cilën Jezusi flet për "shenjat e kohëve", duke i quajtur hipokritë ata, që dinë t'i kuptojnë, por nuk bëjnë të njëjtën gjë me kohën e Birit të Njeriut. Zoti na krijoi të lirë e, për ta pasur këtë liri, pohoi Papa, duhet t'ia hapim zemrat forcës së Shpirtit Shenjt e ta kuptojmë mirë çka po ndodh brenda e jashtë nesh. Gjithnjë duke shtënë në punë forcën e gjykimit:

"E kemi këtë liri ta gjykojmë atë, që ndodh përjashta nesh. Por, për ta gjykuar, duhet ta njohim mirë. E si mund të bëhet kjo? Si mund të bëhet kjo, që Kisha e quan 'të njohësh a të dallosh shenjat e kohëve'? Kohët ndryshojnë. E i takon pikërisht urtisë së krishterë t'i dallojë këto ndryshime, t'i njohë kohët e ndryshme e t'i njohë, sidomos, shenjat e tyre. Të dallojë ç'do të thotë një gjë e ç'do të thotë një tjetër. E ta bëjë këtë pa frikë, me liri të plotë".

Heshtje, reflektim, lutje

Francesku e pranon se nuk është gjë e lehtë; pranon se kushtëzimet e jashtme janë të panumërta, se ndikojnë fuqimisht edhe mbi të krishterët, duke i nxitur disa prej tyre në rrugën më të rehatshme, atë të mosveprimit. I nxitin të mos bëjnë asgjë, duke shtënë në punë gjithfarë shfajësimesh:

“Kjo është një punë, që ne zakonisht nuk e bëjmë: kështu i përshtatemi rrethanave, duke e qetësuar veten me shprehjet: ‘më kanë thënë... e kam dëgjuar... njerëzia thonë... e kam lexuar diku, po nuk e di se ku...’. Kështu ndjehen krejt të qetë... Po cila është e vërteta? Ç’mesazh dëshiron të më japë Zoti me këtë shenjë të kohëve? Për t’i kuptuar shenjat e kohëve, para së gjithash, është e nevojshme heshtja; të heshtësh e të vëresh. E pastaj të reflektosh brenda vetes. Një shembull: pse ka kaq shumë luftëra sot? Pse ndodhi diçka? E të lutemi... Heshtje, reflektim, lutje”.

Vetëm kështu mund t’i kuptojmë shenjat e kohëve, mund ta marrim vesh mirë ç’dëshiron të na thotë Jezusi!

Të lirë në të vërtetën e Ungjillit

E t’i kuptosh shenjat e kohëve nuk është punë, që i takon vetëm një elite kulturore. Jezusi, kujtoi Papa, nuk thotë: “Shikoni si bëjnë universitarët, shikoni si bëjnë doktorët, shikoni si bëjnë intelektualët...”. Jezusi, nënvizoi Francesku, flet për katundarët që, në thjeshtësinë e tyre, dinë mirë ta dallojnë grurin nga egjra:

“Kohët ndryshojnë e edhe ne, të krishterët, duhet të ndryshojmë vazhdimisht. Duhet të ndryshojmë, të patundur në besimin në Krishtin, të patundur në të vërtetën e Ungjillit, por sjellja jonë duhet të lëvizë gjithnjë sipas shenjave të kohëve. Jemi të lirë! Të lirë për dhuratën e lirisë, që na e bëri Jezu Krishti. Por puna jonë është ta vërejmë

mirë atë, që ndodh brenda nesh, të dallojmë ndjenjat tona, mendimet tona: e edhe ç’ndodh jashtë nesh. E t’i dallojmë shenjat e kohëve. Me heshtje, reflektim, lutje!”.



Fear not, Mary, thou hast found grace with the Lord; behold, thou shalt conceive and bring forth a son, alleluia.



Atë Gjergj Fishta
(23.10.1871 – 30.12.1940)

Përkujtimi i lindjes së Atë Gjergj Fishtës në Zadrinë.

Me kremtimin e Meshës dhe mbajtjen e një koncerti, në fshatin Fishtë të Zadrinës, u përkujtua përvjetori i lindjes së franseskanit e poetit të madh të kombit shqiptar, Atë Gjergj Fishtës. Mesha e cemeronia përkujtimore u organizuan nga ipeshkvi i Sapës e Kustodia e Franseskanëve të Shqipërisë.



Giovanni Selmani
Sales Representative
Direct: 647.500.3875

Office: 905.565.9200
Fax: 905.565.6677
E-Mail: gioselmani@hotmail.com
www.rightathomerealty.com

7045 Edwards Blvd., Suite 401
Mississauga, ON L5S 1X2

